



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të

Nr. 15/08

Prishtinë, më 01.12.2008, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Sadik Idriz, Numan Balić, Mursejl Haljilji, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Zafir Berisha.

Anëtarët jo të pranishëm: Enis Kervan, Xhevdet Neziraj.

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruues nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 23 tetor 2008**
- 3. Shqyrtimi i Ligjit në taksën e akomodimit në objekteve hoteliere e turistike me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë e Telekomunikacion, me amendamente**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Faljen me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-019 për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 23 tetor 2008

Kosara Nikolić, bëri vërejtje në diskutimin e saj dhe kërkoi që ato të përmissohen.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 23 tetor 2008, u miratua me vërejtjet e znj Kosara Nikolić.

3. Shqyrtimi i Ligjit në taksën e akomodimit në objekteve hoteliere e turistike me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Ligjin për taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Faljen me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Faljen dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-019 për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Sadik Idriz, kryetar i komisionit funksional, theksoi se kemi të bëjë me një raport i cili është aprovuar nga komisioni, por për shkak të implikimeve buxhetore të konstatuara nga komisioni për buxhet dhe financa, është përpunuar dhe janë bërë disa ndryshime.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamentet të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi për një kërkesë të marrë nga ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, i cili nuk është i kënaqur me buxhetin e aprovuar për këtë Ministri. Për të arsyetuar atë ia dha fjalën ministrit, z. Sasha Rasić.

Sasha Rašić, ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, theksoi se me kërkesën që keni përpara kam kërkuar që të rritet buxheti i kësaj ministrie, sepse me buxhetin aktual nuk mundemi të realizojmë projektet dhe nevojat e mëdha që kanë komunitetet, sidomos realizimin e shpenzimeve kapitale.

Numan Balić, duke ditur faktin se kjo ministri mbulon nevojat e të gjitha komuniteteve, buxheti aktual i miratuar është shumë i vogël. Prandaj duhet gjetur mënyra për ndarje shtesë të këtij buxheti. Kërkoj që Komisionit për buxhet dhe financa ti bëhet një kërkesë ku parashihet rritje e buxhetit të kësaj Ministrie së paku për 20 milion €. Ndërsa më vonë të diskutohet për hartimin e listës për ndarjen dhe realizimin e projekteve për të gjitha komunitetet.

Sanije Aliaj, bëri dy pyetje për ministrin. Pyetja e parë kishte të bënte me atë se a ka rezistuar ai me rastin e miratimit të buxhetit në Qeveri se mjetet e propozuara për këtë Ministri janë të pamjaftueshëm. Dhe pyetja e dytë kishte të bënte me atë se sa projekte kapitale mund të i realizoni me buxhetin aktual. Projektet e propozuara në aneks a konsideroni se plotësojnë nevojat e komuniteteve.

Kryesuesi, theksoi se vetëm buxheti i kësaj Ministrie është i zvogëluar. Duke ditur nevojat e mëdha që ka ajo kërkoj ti drejtohen me një kërkesë Komisionit për buxhet dhe financa që të shikojë mundësin e rritjes së buxhetit të kësaj ministrie.

Sadik Idriz, duke komentuar kërkesën, theksoi pyeti se a janë të radhitura nevojat e komuniteteve në mënyrën të drejtë. Qfarë kapaciteti ka Ministria për menaxhimin e këtyre projekteve. Përkrahu iniciativën për një kërkesë drejtuar Komisionit për buxhet dhe financa dhe se kjo duhet bërë në procedurë të rregullt.

Sanije Aliaj, theksoi se ministri është dashur të jetë më rezistues për një buxhet më të madh në Qeveri. U pajtua me projektet e parapara në aneksin e kërkesës, por kërkoj që me mirëkuptim të realizohen ato. Theksoi se kërkesa duhet të jetë e arsyeshme që të mund të has mirëkuptimin nga Komisioni për buxhet dhe në seancë plenare.

Kosara Nikolić, duke komentuar investimet kapitale të parapara në buxhetin e konsoliduar për komuna, theksoi se shifet se në disa komuna si janë ndarë më shumë mjete si Leposaviq, Zvečan, Zubin Potok, ku minoritetet janë shqiptarët, ndërsa të tilla projektet janë para më pak, si në komunën e Ferizajt. Po ashtu për Mitrovicën janë ndarë pak mjete, ndërsa për dallim prej kësaj në Komunën e Podujevës janë ndarë 4 milion €. Prandaj u pajtua me kërkesën e ministrit për rritje të buxhetit të kësaj Ministrie dhe kërkoj që edhe Komisioni të bëjë një kërkesë për një ndarje të drejtë këtyre mjeteve.

Mursejl Haljilji, përkrahu kërkesën e Ministrisë dhe njëkohësisht kërkoj që komisioni të kërkoj rishqyrtimin e buxhetit të kësaj Ministrie për shkak se mjetet e parapara janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e mëdha që kanë komunitetet.

Hetem Arifi, theksoi se as propozimi prej 20 milion € nuk është i mjaftueshëm për të përkrahur kthimin. Mjetet e parapara për komunitetin ashkali janë të pamjaftueshme. U pajtua me mendimet për ndarjen jo të drejtë të buxhetit për komunat, rasti Podujevës ku nuk ka minoritete janë ndarë mjete të shumtë ndërsa në komunën e Ferizajt edhe pse jetojnë disa komunitete janë ndarë shumë më pak.

Zylfi Merxha, bëri vërejtje për ndarjen jo të drejtë të mjeteve në mes komuniteteve. Theksoi se janë parapri 4.5 milion € për komunitetin serb, 600.000 € për atë turk (Komunën e Mamushës), ndërsa për komunitetin romë mjetet e parapara prej 250.000 € janë të pamjaftueshme, kur dihet fakti se 100.000 romë do të kthehen nga bota jashtme. Prandaj mbështeti kërkesën për mjete shtesë të Ministrisë, por njëkohësisht kërkoi që edhe të bëhet ndryshimi i listës së ndarjes së mjeteve për komunitete.

Müferra Şinik, duke iu përgjigjur parafolësit theksoi se mjetet e ndara për komunën e Mamushës janë të pa mjaftueshme. Gjithashtu theksoi se edhe buxheti i Ministrisë është i vogël. Prandaj kërkoi rritjen e tij. Në këtë drejtim u pajtua me propozimin e z. Balic për kërkesën për rritje të buxhetit prej 20 milion €.

Zafir Berisha, theksoi se buxheti është i gjithë qytetarëve. Përveç nga kjo Ministri, komunitetet përfitojnë edhe nga realizimi i projekteve të përbashkëta nga komunat, ku përfitues janë të gjithë komunitetet që jetojnë në ato komuna.

Sanije Aliaj, u pajtua që të bëhet një amendament më qëllim të rritjes së buxhetit të kësaj Ministrie duke pasur parasysh mundësitë reale të rritjes të buxhetit. Në vazhdim kërkoi disa sqarime për listën shtojcë të projekteve (projekti për zhvillim dhe integrim të komuniteteve, për përfitim Kthim individual).

Numan Balic, insistoi që të hidhet në votim propozimi i tij prej rritje të buxhetit për 20 milion €. Më pas të shikohet lista e ndarjes së projekteve për komunitete.

Kryesuesi, propozoi që ti drejtohen Komisionit për buxhet dhe financa një kërkesë për rritje të buxhetit të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim në shumën prej 8 milion € shtesë në emër të projekteve për komunitete. Në vazhdim kërkoi nga anëtarët të deklarohen më këtë propozim.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se me 10 vota PËR dhe 1 KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni vlerësoi se kërkesa e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë për projektet e komuniteteve për vitin 2009, në shumën prej 8.000.000 € , është e pranueshme dhe e arsyeshme, me qëllim të sigurimit që, të drejtat dhe interesat e të gjitha bashkësive të trajtohen në mënyrë adekuate në Projektligjin për Buxhetin për vitin 2009.
- II. Në pajtim me këtë, Komisioni për Komunitete dhe Kthim i rekomandon Komisionit raportues (Komisionit për Buxhet dhe Financa), që ta ketë parasysh propozimin për mjete buxhetore shtesë në bazë të kësaj kërkesë, me qëllim të plotësimit të obligimeve ligjore për shqyrtimin e të gjitha kërkesave buxhetore, gjatë zbatimit të procesit buxhetor dhe shqyrtimit të Projektbuxhetit për vitin 2009, në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Sanije Aliaj, kërkoi që vizitat nëpër komuna të organizohen më mirë, në takim të marrin pjesë përgjegjësit e komunës, përndryshe nuk ia vlenë të bëhen këto vizita.

Mbledhja përfundoi në ora 14:40

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Bojan STOJANOVIĆ